



Republika e Kosovës
 Republik of Kosova
 Republika Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
 KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
 DREJTORIA E ARSIMIT - UPRAVA ZA OBRAZOVANJE



Komuna e Vitisë
 Municipality of Vitina
 Opština Vitina

Pratuar - Priljetu MaDuar: 20.01.2022

Nr i organit kufir Orgjane	Numri-Broj	Shtojcë Prillog	Vlera Vendnost
05-	32/22		-

Duke u bazuar në nenin 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrtarë Publik Nr.06/L-114, neni 8 të Ligjit për Punë - Nr.03/L-212, Ligjit për Arsimin Parauniversitar Nr.04/L-032 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.151/20, Drejtoria për Arsim e Komunës së Vitisë, më datën 20.01.2022, shpallë:

KONKURS PUBLIK për plotësimin e vendeve të lira të punës

I. Titulli i vendeve të punës:

- Një (1) pozitë Drejtor në Shfmu, „Mirali Sejdiu” në Goshicë, *Rishpallje*.
- Një (1) pozitë Drejtor në Shfmu, „Dom Mikel Tarabolluzi” në Stubell e Epërme.

II. Institucioni: Komuna e Vitisë

Departamenti: Drejtoria për Arsim

Lloji i Pozitës: Jo i karrierës

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtoria për Arsim

Koeficienti: Për drejtor të shkollave të fillore, A-7.8

Orët e punës: 40 orë

Kohëzgjatja e emërimit: 4 vite

Kualifikimi: UA 151/2020, për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës, emërimit të përkohshëm.

Qëllimi i vendit të punës:

Menaxhimi, organizimi dhe mbikëqyrja e procesit arsimor në institucionin edukativo-arsimor.

Detyrat Kryesore:

- Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimit dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollorë;
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimeve, vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mësimeve dhe punëtorët tjerë të arsimit;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së akterëve dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmat tjerë të institucionit arsimor, që kanë rol në vlerësimin e performancës së institucionit dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
- Bashkëpunon me Këshillin Drejtues të Institucionit Edukativo-Arsimor (KDSH-së).

- Këshillin e Arsimitarëve, Këshillin e Nxënëseve dhe komunitetin e institucionit edukativo-arsimor, duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria për Arsim dhe Shkencë;
- Çështjet e tjera, që rregullohen përmes Ligjit për Arsim Parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASHT-i dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët që konkurojnë në këtë konkurs:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/ 4 vite të shkollimit universitar), nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit, sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënëseve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore;
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim;
- Të kenë më së paku 3 vite përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit.

Kandidatët duhet të kenë dhe dorëzojnë këto dokumente:

- Çertifikatën e lindjes;
- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës;
- Dëshminë për përvojën e punës;
- Portofolin profesional (shih shtojcën G);
- Letërreferencë nga një institucion publik - kredibil (Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, DKA, këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë);
- Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake.
- Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues, për të cilin ka konkurs (së paku 10 faqe tekst, me hapësirë 1.5, fondi i shkronjave me 12, arial), sipas udhëzimit të MASHT-it;
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion shëndetësor publik, me të cilën dëshmohet gjendja e tij / saj shëndetësore;
- Dëshminë se nuk është nën hetime;
- Kopjen e letërnjoftimit.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegje private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurojnë për këtë pozitë, duhen, që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr.8/2010, të datës 22.06.2010. Në të kundërtën, komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet e konkursit.

Aplikimi mbetet i hapur 15 ditë nga data 20.01.2022 deri më 03.01.2022.

- Kandidatët e interesuar aplikacionet i marrin dhe i dorëzojnë në Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Vitisë.
- Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Viti, më 20.01.2022



Drejtori i DKA-së

Fatbardha Emiri/Halabaku